

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI****VENDIM****Nr. 191, Datë 20.11.2020****“MBI****NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 219, DATË 20.12.2019,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PANARIT” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HIDROCENTRALI “VILË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 KW”.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të “Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 122/3 prot., datë 17.11.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi shfuqizimin e pikës 3 të vendimit të bordit të ERE-s, Nr. 219, datë 20.12.2019,

**Konstatoi se:**

1. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 219, datë 20.12.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vilë” me kapacitet të instaluar 1994 kW”, vendosi në pikën 3 të këtij vendimi, që “Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e mjedisit të rinovuar jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 03.08.2020”.
  - Në lidhje me vlefshmërinë e afatit kohor të lejeve mjedisore/VNM, AKM ka sqaruar se:
    - Nëse veprimtaria nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të vendimit për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.
  - Përsa i përket faktit nëse vlefshmëria e VNM-së shtrihet për kohën kur ndërtohet vepra apo duhet të përfshijë të gjithë periudhën/vitet referuar kontratës me Autoritetin kontraktor (MIE), AKM-ja ka sqaruar se:
    - HEC-i është një aktivitet që ka ndikim në mjedis vetëm gjatë fazës së ndërtimit dhe nuk ka ndikim gjatë fazës së funksionimit. Kjo është arsyeja që i nënshtrohet vetëm procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe nuk aplikon më pas për Leje mjedisore. Pra, në momentin që vepra përfundon së ndërtuari, ndikimi në mjedis është zero (0). Për këtë arsye VNM nuk rinovohet.

- Me shkresën nr.519 prot, datë 24.02.2020, ERE i ka kërkuar informacion shoqërisë në lidhje me ecurinë dhe fazën në të cilën ndodhen punimet për ndërtimin e veprës.
- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr.519/1 prot, datë 02.03.2020, shoqëria ka bërë me dije ERE-n se kanë përfunduar ndërtimet e veprës dhe se shoqëria është në pritje të testimit të veprës dhe vënien në shfrytëzim të impiantit prodhues.
- Me konfirmimin e ndërtimit të veprës, rezulton i plotësuar kushti i parashikuar në VNM paraprake që lidhet me vlefshmërinë e këtij dokumenti, si dhe kushti i parashikuar në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE nr.219/2019
- Gjithashtu, në bazë të raportimeve të Furnizuesit të tregut të lirë (FTL) sh.a., rezulton se aktualisht shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., është në operim.
- Detyrimi i vendosur për shoqërinë në pikën 3 të vendimit të bordit të ERE nr.219/2019, ka rënë me plotësimin e rrethanave, që çuan në vendosjen e tij.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Shfuqizimin e pikës 3, të vendimit të bordit të ERE, Nr. 219, datë 20.12.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “Hydro Power Panarit” sh,p,k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vilë” me kapacitet të instaluar 1994 kW”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**